



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0188

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Vedat Poterqoi Kryetar i panelit, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, (OE) “Dwh-Kosova sh.p.k.” dhe ankesën (OE) “Geo Tech” sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument GPS” me nr. të prokurimit:632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Gjakovës, më datën 13.06.2023, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik “Dwh-Kosova sh.p.k.” me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.04.2023 (me numër protokolli 188/2023),ndërkaq **refuzohet** si e pa bazuar, ankesa e Operatorit Ekonomik “Geo Tech” sh.p.k., me seli në Fushë Kosovë,nr.200/2023, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument GPS” me nr. të prokurimit:632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna e Gjakovës.

2.Anulohet, B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të kontratës për procedurën e prokurimit:“Furnizim me instrument GPS”,me nr. të prokurimit 632-22-7865-1-2-1,ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër kthehet në **rivlerësim**.

3.Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

4.Me qenë se ankesa e Operatorit Ekonomik “Dwh-Kosova sh.p.k.” me seli në Prishtinë, aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5.Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues “Geo Tech” sh.p.k., i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me date 03.08.2022 AK ka bërë publikimin e Njoftimit për kontratë, ndërsa me datë 27.02.2023 është bërë hapja e tenderëve. Me 27.03.2023, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 njoftimin për dhënie të procedurës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument GPS”, me nr. të prokurimit 632-22-7865-1-2-1.

Me datë 30.03.2023, Operatori Ekonomik “Dwh-Kosova sh.p.k.”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK Komuna e Gjakovës, me datë 03.04.2023, AK Komuna e Gjakovës, eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues.

Me datën 07.04.2023, Operatori Ekonomik “Dwh-Kosova sh.p.k”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 188/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK.

Me datë 30.03.2023, Operatori Ekonomik “Geo Tech” sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi Komunal Gjakovës, me datë 03.04.2023 AK Komuna e Gjakovës e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 27.03.2023.

Me datën 12.04.2023 Operatori Ekonomik “Geo Tech” sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 200/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 20,000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertët vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që të njëjtit në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 12.04.2023, ekspertët e jashtëm shqyrtues kanë dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “Dwh-Kosova sh.p.k.” të aprovohet si e bazuar.

- ankesa e OE ankues “Geo Tech” sh.p.k., të refuzohet si e pa bazuar,

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 27.03.2023 dhe lënda të kthehet në rivlerësim (njoftimi për dhënie të kontratës).

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Dwh-Kosova sh.p.k”

AK me vendimin e dt.03.04.2023 ka hedh poshtë Pretendimet e OE ankues duke dhënë këto kundër argumente në pretendimet e OE ankues:

1.AK ka vendos që ta anuloj aktivitetin e Prokurimit me arsyetimin se as një OE nuk është i përgjegjshëm, ku në njoftimin për vendim të anulimit të aktivitetit të prokurimit jep arsyet për secilin OE veç e veç pse është i pa përgjegjshëm.

2.AK pas shqyrtimit të kërkesës së OE ankues konstaton se pretendimi juaj i pare nuk qëndron, sepse nuk kemi problem me formën e prezantimit të specifikimeve tuaja si OE, nuk është motiv shkarkimi forma e prezantimit mirëpo ne si AK ju kemi refuzuar sepse specifikimet teknike që kemi kërkuar nuk përputhen me atë që keni ofruar ju.

Më konkretisht të kontrollori i antenës së GNSS ne kemi kërkuar një hapësirë memorizuese jo më të vogël se 64GB, ndërsa ju keni ofruar një pasje me hapësirë memorizuese 4GB.

Gjithashtu ne si AK, kemi kërkuar që pajisja e ofruar (GPS) të mundësoi export/import të të dhënave gjeohapsinore në formatet DWG, CSV, Shape File, TXT, ndërsa ju si OE në broshurat e ofruara keni prezantuar DWG/DXF(është kërkuar që të vërtetohet përmes screenshot-ave në softuer se cili format ekziston ndërmjet DWG/DXF).

Gjithashtu mungojnë edhe formatet tjera të të dhënave si CSV, ShapeFile, TXT (Nëse këto formate ekzistojnë atëherë të argumentohen përmes screenshot-ave në softuerin e instrumentit).

3.Pretendimi juaj i dytë gjithashtu është i pa bazuar , sepse Komisioni i vlerësimit, përbëhet prej gjeodetëve që besojmë se është e mjaftueshme për vlerësimin e specifikimeve teknike të instrumenteve.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertët shqyrtues me dy raporte të ekspertizave i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues Dwh-Kosova sh.p.k. me seli në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim, ndërkah ankesa OE ankues “Geo Tech” sh.p.k., me seli në Fushë Kosovë, të refuzohet si e pabazuar.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertizat e ekspertëve shqyrtues, po ashtu angazhimi edhe i një eksperti tjetër për përpilimin edhe të një ekspertize tjetër ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertëve shqyrtues, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertëve shqyrtues dhe mendimet e tyre janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE “Dwh-Kosova sh.p.k., të aprovohet si e bazuar, si dhe konform mendimit të raporteve të ekspertëve shqyrtues të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 27.03.2023 për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa ankesa e OE ankues “Geo Tech” sh.p.k., të refuzohet si e pabazuar.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS, KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - DWH-KOSOVA SH.P.K., " GeoTECH " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: